

VENDIM

Nr. 796, datë 22.9.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË PRONËS NR. 98, ME EMËRTIM “GRUP DEPO (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011)”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË DISA OBJEKTEVE E TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 6, ME EMËRTIM “INSTITUTI GJEOGRAFIK I USHTRISË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “MYSLYM KETA”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës nr. 98, me emërtim “Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe dhënie në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 30-vjeçare, të disa objekteve, si dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5 931,2 (pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një presje dy) m², brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për vendosjen e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për plotësimin e nevojave institucionale të këtij institucioni.

2. Prona nr. 98, me emërtim “Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, sipas planvendosjeve, t’i tjetërsojnë ato apo t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama